



# RisiAlbania

Partner for Growth

*Historia frymëzuese e Aleksias  
Rrugëtimi i Aleksias me 'Think Big', programi  
mediatik që "hap dyer"!*

**Aleksia Bega**



Pas shumë intervistash pune, një episod online i emisionit 'Think Big' iu duk Aleksias si shenja që i duhej për çfarë do të ishte hapi i saj i radhës. Emisioni 'Think Big', i mbështetur nga RisiAlbania, i shtyn të rinjtë të mendojnë përtej të zakonshmes, siç është edhe moto e tyre.

Në episodin ku mbetën sytë dhe ku zemra e Aleksias rrahu fort, ishte në qendër kompania EasyPay. Me formatin e tij inovativ, emisioni Think Big në çdo episod, sjell në vëmendje të audiencës një kompani të suksesshme dhe trajton sfidat dhe arritjet e kompanisë dhe industrisë ku operon. Kjo realizohet nëpërmjet këndvështrimit dhe përvojës të CEOs, burimeve njerëzore, të të rinjve të punësuar pranë asaj kompanie për të sjellë tek të rinjtë e tjerë çfarë fshihet pas suksesit, dhe për të përcjellë vlerat dhe aftësitë për t'ia dalë në tregun e punës. Edhe në këtë episod, themeluesja dhe punonjës të tjerë të kompanisë EasyPay nëpërmjet rrëfimeve pasionante treguan se si kishin filluar, si kishin evoluuar, si kishin tejkaluar sfidat, sa ishin rritur ndër vite, apo çfarë do të thotë të punosh për ta. Për Aleksian ky rrëfim, u shndrrua në një frymëzim, e pa vonuar edhe në vendimin se kjo ishte puna e duhur për të.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkepunim DSC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkepunim DSC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



"Aleksia një vajzë e qeshur, me një zë të ëmbël dhe plot entuziazëm e ka ende të freskët shijen që i la programi 'Think Big'. Ajo kujton si dje frymëzimin që e kaploi, pasi ndoqi mënyrën tërheqëse se si në emisionin Think Big ishte zbrërthyer dhe trajtuar puna e kompanisë Easy Pay. Ditën që e kontaktuam, Aleksia ishte në universitet, një fakt optimist ky, pasi dëshira e saj për të punuar nuk e ka lënë aspak mënjë investimin e saj akademik.

"Në vitin e dytë të studimeve për inxhinieri kompjuterike vendosa të ndiqja një kurs për t'u specializuar në Java (një gjuhë programimi), dhe pas përfundimit të këtij kursi me sukses, nisa kërkimin tim për të gjetur një kompani në të cilën do të kisha mundësinë të merrja eksperincë si dhe të zhvillohesha më shumë si programuese. Kisha dhënë disa intervista në disa kompani, por diçka brenda meje nuk ishte e sigurtë për vazhdimin tim me to", nis të tregojë rrugëtimin e saj Aleksia.

Një ditë të zakonshme për të, e gjendur midis dilemave se cila nga këto kompani do ishte e duhura për të, ajo shton: "Para meje doli video e 'Think Big'. Për EasyPay kisha dëgjuar prej disa vitesh, dhe çdo ditë kaloja para pikave të tyre në Tiranë kështu që kureshtja dhe formati i emisionit më shtynë që të vijoj ta ndjek episodin. Konceptimi i emisionit sillte natyrshëm idenë se si mund të punoje me ta".

"Kontaktova kompaninë duke i dërguar një email ku i shpjegoja se do të më pëlqente shumë nëse do të më jepnin mundësinë të nisja një internship, duke bashkangjitur edhe CV-në time". Dy ditë më vonë Aleksia mori një përgjigje nga kompania dhe një orar për intervistë. "Intervista shkoi me sukses dhe menjëherë e kuptova që kjo kompani mund të më ofronte shumë përsa i përket zhvillimit tim profesional". Aleksia e tregon me kaç shumë detaje historinë e saj sa që mban mend dhe datën 2 Shtator, dita e saj e parë në zyrë si një 'android mobile developer'.

"Para se të hyja në derën e kompanisë kisha ankth, nëse do të mundesha të përshtatesha lehtë me punën si dhe me ambjentin, por sa hyra dhe u përshëndeta me të gjithë, të gjitha emocionet e mia negative u larguan dhe ashtu si ditën e intervistës mikpritja ishte e ngrohtë dhe u ndjeva menjëherë pjesë e grupit".

Tani Aleksia vijon internshipin dhe e mbyll bisedën me të njëjtin entuziazëm si në fillim: "Mund të them me bindje se nuk e di nëse do kisha gjetur një ambient më profesional për hapat e mi të parë në karrierë dhe i jam shumë mirënjohëse emisionit 'Think Big', i cili më ndryshoi jetën".

"Think Big", me prezantimin që i bën tregut të punës, inspiron të rinjtë dhe të rejtat, të cilët si rasti i Aleksias nuk guxojnë të trokasin në 'dyert' e kompanive që ndërrojnë njëkohësisht edhe duke i informuar për mundësitë në treg. 'Think Big', i hap këto dyer, për të frymëzuar të rinjtë që të mendojnë përtej të zakonshmes dhe të guxojnë! Aleksia guxoi dhe kontaktoi drejtëpërdrejtë kompaninë që i rrëmbeu zemrën dhe nuk u zhgënjye! Secili nga ne mund të jetë vetëm një email larg realizimit të karrierës së dëshiruar!

